VENDIM
Nr.22, datë 30.12.2003

PËR ÇMIMET DHE TARIFAT E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2004

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.12.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26 pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga KESH sh.a., si dhe materialin përkatës,

VENDOSI:

1. Çmimet dhe tarifat e shitjes së energjisë për vitin 2004 të jenë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

BORDI I KOMISIONERËVE TË ERE-S

ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË APROVUARA NGA ERE PËR VITIN 2004

	Kategoritë e konsumatorëve	Çmimi lekë/kWh
TL	Buxhetore	8.3
	Jobuxhetore- ujësjellës	5.5
	Jobuxhetore- të tjerë	8.3
	Private	8.3
	Media	7
TM	Buxhetore	9
	Jobuxhetore-ujësjellësi	5.6
	Jobuxhetore (nafta, kromi, çimento, plehra kimike)	8.4
	Jobuxhetore- furnizuar në TM, matur në TM	10.5
	Jobuxhetore- furnizuar në TM, matur në TL	11
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhim mielli, stacione pompimi	5.7
	Privatë të favorizuar-objekte kulti	5.8
	Privatë- furnizuar në TM, matur në TM	10.4
	Privatë-furnizuar në TM, matur në TU	10.5
	Media	7
TU	Buxhetore	9.5
	Jobuxhetore-ujësjellësi	6.5
	Jobuxhetore (nafta, kromi, bakër, çimento, plehra kimike)	8.5
	Jobuxhetore- furnizuar në TU	12
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhime mielli, stacione pompimi	6
	Privatë të favorizuar-objekte kulti	6
	Privatë-furnizuar në TU	12
	Familjarë nën 220 kWh	4.5
	Familjarë mbi 220 kWh	8.9
	Media	7.5

Shënim. Energjia e përdorur për ambientet e përbashkëta (Ndriçim shkalle, ashensor, pompë

uji) do të faturohen me çmimin prej 4,5 lekë/kWh.

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.105/2003, në ligjin nr.9161, datë 18.12.2003 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, në faqen 4530:

Është	Bëhet:
Pasqyra nr.3	Hiqet pasqyra nr.3